LIGJ
Nr.7631, datë 29.10.1992

PËR FALIMENTIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Falimentimi është një situatë juridike, e cila vjen si pasojë e paaftësisë paguese të ndërmarrjes për një kohë të caktuar. Falimentimi shpallet me vendim të gjykatës.

Neni 2

Ndërmarrja i nënshtrohet procesit të falimentimit, kur nuk ka aftësi paguese të mjaftueshme dhe kreditorët i kërkojnë asaj kryerjen e pagesave të prapambetura. Falimentimi kërkohet nga kreditorët që mbajnë përqindjen më të lartë të borxhit ose nga ministria a institucioni tjetër qendror, apo nga organet e pushtetit lokal sipas vartësisë së ndërmarrjes.

Neni 3

Objekti i falimentimit është e gjithë pasuria e ndërmarrjes shtetërore, përfshirë edhe atë të filialeve ose degëve të saj.

KAPITULLI II
GJENDJA E NDËRPRERJES DHE E NDALIMIT TË PAGESAVE

Neni 4

Ndërmarrja shtetërore konsiderohet në gjendje të ndërprerjes së pagesës, kur:

a) borxhet e saj kalojnë vlerat disponibël (kambialet për t'iu paguar, aksionet, titujt, obligacionet, çeqet postale, mjetet monetare në arkë) ose,

b) ajo s'ka vlera të realizueshme (paradhënie që u ka dhënë furnitorëve, klientëve dhe debitorëve të tjerë me afat më pak se një vit e gjashtë muaj) të majftueshme për t'u shlyer borxhet në afatet e caktuara.

Neni 5

Ndërmarrja në gjendje të ndërprerjes së pagesave duhet t'u kërkojë kreditorëve dhe bankës që të arrijnë një marrëveshje për rivendosjen e aftësisë paguese brenda një afati të caktuar.

Neni 6

Lidhur me marrëveshjen për rivendosjen e aftësisë për të paguar ndërmarrja dorëzon një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me:

a) një raport që paraqet shkaqet dhe natyrën e ndërprerjes së pagesave, masat e parashikuara

nga ndërmarrja për rivendosjen e aftësisë paguese, kërkesat e saj për të shtyrë afatet e pagesave, kreditë bankare suplementare dhe asistencë tjetër;

b) një parashikim të financimit të veprimtarisë së saj dhe rezultatin financiar vjetor të pritshëm;

c) një listë të gjithë aktiveve dhe pasiveve, duke përfshirë aktive dhe pasive të diskutueshme ose jo të sigurta, dhe gjithë listën e kreditorëve.

Drejtori i ndërmarrjes ose personi i ngarkuar me nxjerrjen dhe llogaritjen e të dhënave, kur falsifikojnë informacionin që lidhet me këtë proces, përgjigjen sipas Kodit Penal.

Neni 7

Ministria ose institucioni tjetër qendror apo organet e pushtetit lokal, sipas vartësisë së ndërmarrjes, banka, ndërmarrja dhe kreditorët që përfaqësojnë mbi 50 për qind të detyrimeve të ndërmarrjes, duhet të nisin bisedime për një marrëveshje të tillë, e cila nuk mund të zgjasë më shumë se 15 ditë.

Neni 8

Marrëveshja duhet të përcaktojë mënyrën e funksionimit e të riorganizimit të ndërmarrjes, si dhe mjetet e përparësitë për mbledhjen dhe shpërndarjen e pasurive.

Marrëveshja për kapërcimin e gjendjes së ndërprerjes së pagesës duhet miratuar e nënshkruar nga drejtori i ndërmarrjes shtetërore, përfaqësuesi i bankës, përfaqësuesi i ministrisë ose i organeve të pushtetit lokal nga varet ndërmarrja dhe nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë. Marrëveshja duhet miratuar nga shumica e anëtarëve të komitetit të kreditorëve që krijohet e funksionon sipas dispozitave nënligjore dhe përbëhet nga kreditorët kryesorë të ndërmarrjes.

Kreditorët jopjesëmarrës mund të kundërshtojnë marrëveshjen në gjykatë, ku e ka qendrën (selinë) ndërmarrja, dhe gjykata mund të miratojë marrëveshjen ose të deklarojë që të ketë një gjendje të ndalimit të pagimit sipas neneve 10-16 të këtij ligji.

Neni 9

Ndërmarrja shtetërore konsiderohet në gjendje të ndalimit të pagesës, kur ajo nuk arrin një marrëveshje me bankën dhe me kreditorët, ose kur afati i fundit që jepet në marrëveshje, skadon dhe ndërmarrja nuk plotëson detyrimet e saj.

Neni 10

Ndërmarrja shtetërore deklarohet në gjendje të ndalimit të pagesës nga gjykata ku e ka qendrën ajo, me kërkesë të bankës, kreditorëve ose nga ministria e institucioni tjetër qendror ose nga organet e pushtetit lokal, sipas vartësisë së ndërmarrjes.

Kërkesa mund të paraqitet në gjykatë brenda 15 ditëve pas datës së skadimit të afatit të fundit të marrëveshjes ose përfundimit të pagesave.

Neni 11

Për të filluar procedurat e shpalljes së gjendjes së ndalimit të pagesave, gjykata kërkon nga ndërmarrja të paraqesë dokumentet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

Brenda 15 ditëve pas paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar gjykata informon të gjitha bankat dhe kreditorët e ndërmarrjes, ministritë e institucionet e tjera qendrore përkatëse, si dhe organet e pushtetit lokal, për kërkesën për shpalljen e gjendjes së ndalimit të pagesave dhe të procedurës së gjykatës për gjykimin (hetimin) e çështjes.

Neni 12

Gjykata përcakton periudhën e mbikëqyrjes së mundësisë së rivendosjes së aftësisë paguese të

ndërmarrjes, e cila nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj.

Me këtë rast gjykata emëron një administator të ndërmarrjes, i cili caktohet si mbikëqyrës. Administratori do të zgjidhet nga lista e personave të kualifikuar, të miratuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë. Gjykata vendos nëse Administratori do të punojë me kohë të pjesshme ose me kohë të plotë dhe, mbi këtë bazë, edhe për shpërblimin e punës. Në rast se administratori punon me kohë të plotë, i ruhet vendi i tij i punës.

Gjykata mund të caktojë gjithashtu një përfaqësues të krditorëve dhe një përfaqësues të punonjësve të ndërmarrjes. Ky i fundit zgjidhet sipas kritereve të përcaktuara në nenin 27 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarjet shtetërore".

Neni 13

Me fillimin e procedurës së shpalljes së ndalimit të pagesës, ndërmarrja duhet t'i japë administratorit të gjitha dokumentet dhe librat kontabël.

Administratori organizon menjëherë punën për të vërtetuar aktivet dhe pasivet e ndërmarrjes.

Neni 14

Gjatë periudhës së mbikëqyrjes administratori duhet të organizojë punën për përgatitjen e bilancit të ndërmarrjes dhe një projektprogram për rivendosjen e aftësisë paguese të ndërmarrjes.

Administratori mund të kërkojë dhe të marrë ekspert kontabël, juristë etj., për të kryer një analizë të gjithë punës së ndërmarrjes.

Neni 15

Në fund të periudhës së mbikëqyrjes administratori i paraqet gjykatës një raport të hollësishëm për gjendjen financiare, ekonomike dhe problemet sociale të ndërmarrjes bashkë me dokumentet mbështetëse. Nëse administratori rekomandon vazhdimin e veprimtarisë së ndërmarrjes, raporti i tij duhet të përfshijë edhe përcaktimin e të drejtave të kreditorëve dhe një plan për mbledhjen dhe shpërndarjen e aktiveve.

Vendimi për vijimin e veprimtarisë së ndërmarrjes merret nëse shumica e kreditorëve kryesorë të ndërmarrjes, së bashku me ministrinë përkatëse ose institucionin tjetër qendror apo organet e pushtetit lokal nga varet ndërmarrja, kanë pranuar dhe firmosur raportin e administratorit.

Gjykata vendos përfundimisht nëse do të vazhdojë veprimtarinë ose do të likuidohet.

Neni 16

Ndërmarrja, brenda 10 ditëve nga dhënia e vendimit të gjykatës, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën e apelit.

Neni 17

Në rast se ka kërkesë për të përfunduar një marrëveshje sipas nenit 6 ose për të shpallur ndalimin e pagesave sipas nenit 11, kreditorët janë të ndaluar të ndjekin ose të detyrojnë me forcë kërkesat individuale kundrejt ndërmarrjes debitore dhe kjo ndërmarrje s'ka të drejtë të shfrytëzojë pasurinë e saj në kundërshtim me këtë ligj.

KREU III
LIKUIDIMI

Neni 18

Procesi i likuidimit fillon vetëm pas dhënies së vendimit të gjykatës siç parashikohet në nenin 16. Me hapjen e procesit të likuidimit, të gjitha veprimet kryhen nga likuiduesi ose nën mbikëqyrjen e tij. Gjykata mund të zgjedhë një likuidues nga lista e personave të kualifikuar, të miratuar nga

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Gjykata vendos nëse likuiduesi do të punojë me kohë të pjesshme ose me kohë të plotë dhe mbi këtë bazë, edhe për shpërblimin e punës. Në rast se likuiduesi punon me kohë të plotë, i ruhet vendi i tij i punës.

Neni 19

Likuiduesi, brenda 14 orëve pas emërimit të tij, bën mbylljen dhe vulosjen e magazinave e të arkave të ndërmarrjes dhe të filialeve ose degëve të saj, si dhe merr në ngarkim të gjitha dokumentet dhe librat kontabël. Çdo veprimtari e ndërmarrjes kryhet nën drejtimin rigoroz të likuiduesit.

Neni 20

Likuiduesi është i detyruar të përgatitë dhe të mbajë një inventar të saktë të aktiveve dhe pasiveve të ndërmarrjes.

Neni 21

Likuiduesi u kërkon gjithë kreditorëve të ndërmarrjes të llogaritin detyrimet që ata kërkojnë. Kreditorët e ndërmarrjes, të shpallur në likuidim, janë të detyruar t'i raportojnë likuiduesit masën e detyrimit të kërkuar, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së kërkesës.

Likuiduesi duhet të verifikojë regjistrimet financiare të ndërmarrjes dhe kërkesat e parashtruara nga kreditorët, duke përdorur ekspertë kontabël ose të tjerë, po të jetë nevoja, dhe në përfundim vendos vetëm pasi bindet se ato janë të sakta.

Kreditorët kanë të drejtë të paraqesin ankesa (probleme) ndaj kërkesave të kreditorëve të tjerë te likuiduesi, vendimi i të cilit për kërkesat e kreditorëve mund të apelohet në gjykatë.

Neni 22

Likuiduesi verifikon detyrimet e palës së tretë kundrejt ndërmarrjes në likuidim dhe përcakton masat për mbledhjen e tyre.

Likuiduesi vazhdon me zgjidhjen e kontratave me klientët dhe merr masa për shitjen e produkteve që mund të prishen ose zhvlerësohen.

Neni 23

Me plotësimin e operacioneve të parashikuara në nenet 20-22 të këtij ligji, likuiduesi përgatit llogaritë për likuidimin e ndërmarrjes:

1. Bilancin kontabël.
2. Listën e kreditorëve të ndërmarrjes dhe shumën përkatëse.
3. Listën e debitorëve të ndërmarrjes, detyrimet e të cilëve s'janë mbledhur ende.
4. Vlerësimin e bilanceve aktive të realizuara të ndërmarrjes.

Neni 24

Brenda 15 ditëve nga fillimi i likuidimit, likuiduesi duhet të thërrasë ose t'u kërkojë kreditorëve që të shfaqin mendim për përparësitë dhe afatet e fundit të shlyerjes së detyrimeve, të bazuara në një propozim paraprak të paraqitur prej tij.

Neni 25

Llogaritë vjetore dhe propozimi për mënyrën, përparësinë dhe afatet e fundit të shlyerjes së detyrimeve i paraqiten nga likuiduesi gjykatës, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të kreditorëve.

Neni 26

Në rast se kreditorët kundërshtojnë mënyrën, përparësinë dhe afatet e fundit të shlyerjeve, gjykata e shqyrton çështjen në prani të palës së interesuar dhe merr vendimin përkatës.

Neni 27

Kreditorët mund të bëjnë ankesë në gjykatën e apelit për vendimin e marrë nga gjykata ku e ka qendrën ndërmarrja, brenda afateve të caktuara me ligj.

Neni 28

Mbi bazën e vendimit të gjykatës, likuiduesi procedon me shitjen e aktiveve (pasurive) të ndërmarrjes dhe shlyerjen e detyrimeve sipas rrjedhës që ajo përcakton.

Neni 29

Me përfundimin e të gjitha veprimeve të lidhura me shitjen e aktiveve (pasurive) të ndërmarrjes dhe shlyerjen e detyrimeve të verifikuara, likuiduesi përgatit llogarinë përfundimtare të likuidimit në formën e një bilanci, që e depoziton në gjykatë:

Bilanci përfundimtar përmban:

1. Bilancin e llogarive të mjeteve monetare në grupin aktiv.
2. Kapitalin ose rezervat që kanë mbetur të pashpërndara në grupin pasiv.
3. Shpenzimet gjatë procesit të falimentimit.

Në aneks të bilancit duhet të jepen të dhëna për vlerën e realizuar nga shitja e aktiveve, shuma e përgjithshme e detyrimeve të paguara kreditorëve dhe detyrimet e debitit të bledhura, si dhe ato të dhëna të tjera të nevojshme sqaruese.

Neni 30

Kur shlyerja e detyrimeve të gjithë kreditorëve është e amundur me bilancin aktiv, shumat e tyre paraqiten në bilancin asiv dhe një listë e hollësishme paraqitet në shtesë.

Çdo aktiv që mbetet pas likuidimit, derdhet në buxhetin e htetit.

Neni 31

Mbi bazën e llogarisë përfundimtare të likuidimit, gjykata err vendim për likuidimin e ndërmarrjes, me hyrjen në fuqi të ë cilit:

a) eliminon detyrimet e kreditorëve, që nuk janë paraqitur he nuk janë paguar, si dhe detyrimet debitore të pambledhura;

b) i jep fund funksioneve të likuiduesit;

c) i jep fund qenies së ndërmarrjes si person juridik.

Neni 32

Dokumentet dhe librat kontabël të ndërmarrjes së likuiduar uhen sipas dispozitave të ligjit mbi arkivat.

KAPITULLI IV
DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 33

Personat që emërohen nga gjykata si administratorë ose ikuidues, duhet të japin pëlqimin e tyre gojor ose me shkrim ër këtë emërim brenda 3 ditëve nga dita e njoftimit. Nëse ky fat i fundit nuk

respektohet, vendimi anulohet dhe gjykata duhet ë emërojë persona të tjerë si administratorë ose likuidues.

Neni 34

Gjykata ka të drejtë të pushojë likuiduesin ose dministratorin dhe ta zëvendësojë atë me një likuidues a dministrator tjetër, nëse ajo çmon se likuiduesi ose dministratori nuk i plotëson detyrat e tij.

Neni 35

Likuiduesi ose administratori mbajnë përgjegjësi disiplinore se penale për shkelje të rregullave që përcaktohen sipas ispozitave ligjore në fuqi.

Neni 36

Objektet e pasurisë së ndërmarrjes që është likuiduar, lerësohen me çmimin e arritur në treg.

Neni 37

Urdhri për shlyerjet, për shpenzimet dhe detyrimet e dërmarrjes në likuidim duhet të jetë sipas kësaj rradhe:

- detyrime ndaj kreditorëve të siguruar;
- detyrime ndaj kreditorëve të pasiguruar;
- shpenzimet e procesit të likuidimit;
- detyrimet ndaj punonjësve për pagat dhe sigurimet hoqërore.

Neni 38

Shteti nuk mban përgjegjësi për detyrimet që mbeten të apaguara pas likuidimit të ndërmarrjes.

Neni 39

Për punonjësit që mbeten pa punë pas falimentimit të dërmarrjes zbatohen dispozitat e ligjit nr.7579, datë 2.7.1992 Për përkrahjen sociale për personat që dalin të papunë nga batimi i reformës ekonomike".

Neni 40

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1993.

Shpallur me dekretin nr.345, datë 12.11.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.